



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01 Nr.60/01-29344/24
Kaçanik 19.11.2024

FTESË PËR MBLEDHJE

Të nderuar anëtarë të Komitetit për Komunitete, me datën 27.11.2024 (e Mërkurë), do të mbahet mbledhja e IX (nëntë) e rregullt e Komitetit për Komunitete, për vitin 2024.

Mbledhja do të mbahet në katin e dytë të objektit të komunës në sallën e Komiteteve, më fillim pune në ora 13:00.

Mbledhjen do ta kryeson dhe udhëheq, Ekrem Livoreka, Kryesues i Komitetit për Komunitete.

Në mbledhjen e IX (nëntë) të Komitetit për Komunitete, të datës 27.11.2024, do të shqyrtohet ky:

REND PUNE

- 1.Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Komunitete ;
- 2.Gjendja e bizneseve në komunën e Kaçanikut;
- 3.Të ndryshme.

Ju mirëpresim,

Me respekt!

Kryesues i Komitetit për Komunitete
Ekrem Livoreka



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr. 60/01-27104/24
Kaçanik, 29.10.2024

PROCESVERBAL

Nga mbledhja **VIII (tetë)** e Rregullt e Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 29 tetor 2024 (e Martë). Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës Komunale, në sallën e komiteteve, me fillim pune në ora 13:00. Pjesëmarrës të këtij takimi nga Komiteti për Komunitete ishin: Lejla Muhaxheri – Çaka - PDK, Arta Avdiu-LVV, Ekrem Livoreka-AAK, Betim Shala-LDK, Arben Thaqi - OJQ. Në takim mori pjesë Sinan Zeneli – Drejtor i QKMF-së në komunën e Kaçanikut.

Mbledhjen e udhëhoqi, kryesuesi i Komitetit për Komunitete, Ekrem Livoreka. Procesmbajtëse Mavije Murseli, Asistente e Kryesuesit të Kuvendit.

z.Ekrem Livoreka: Fillimisht përshëndes të pranishmit, konstatoj kuorumin dhe hapi mbledhjen e VIII -të (tetë) të rregullt të Komitetit për Komunitete për vitin 2024, data 29 tetor, me këtë :

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Komunitete;
2. Gjendja aktuale e QKMF-së në komunën e Kaçanikut; dhe
3. Të ndryshme.

Nëse ka diçka rreth rendit të punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendi i punës u shtrua në votim dhe u votua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së Komiteti për Komunitete.

APROVOJ

Rendin e punës, në përbërje prej 3 pikave

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas renditjes:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e fundit e Komitetit për Komunitete

Kryesuesi i Komitetit, Ekrem Livoreka: A keni ndonjë vërejtje në lidhje me procesverbalin e mbledhjes së kaluar? Nëse jo, a jeni dakord për miratimin e tij?

Procesverbali i mbledhjes së VII (shtatë) të Komitetit për Komunitete për vitin 2024 u miratua njëzëri. Si pasojë, konstatimi është se Komiteti për Komunitete.

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes se VII (shtatë) të Komitetit për Komunitete të vitit 2024, të datës 19.06.2024 / Lënda : 01Nr. 60/01-23935/24.

2. Gjendja aktuale e QKMF-së në komunën e Kaçanikut:

z.Sinan Zeneli: Puna gjatë periudhës janar-qershor 2024 ka shkuar mirë. Punëtorët kanë respektuar orarin dhe disiplinën në punë, dhe të gjitha shërbimet shëndetësore ndaj qytetarëve janë kryer siç është parashikuar.

Gjatë periudhës janar-qershor 2024, në QKMF dhe në terren janë kryer gjithsej 99,658 shërbime shëndetësore. Prej tyre, janë realizuar 44,906 kontrolla mjekësore, 55,992 shërbime infermierike, dhe janë referuar për në spital 4,771 raste. Në urgjencë, janë trajtuar 16,539 pacientë, janë dhënë 20,239 injeksione dhe 10,380 infuzione. Po ashtu, janë realizuar 6,954 lidhje dhe pastrime plagësh, 3,061 EKG, 1,471 inhalime dhe 1,682 vizita shtëpiake.

Për grupet specifike, janë realizuar 921 vizita shtëpiake për nënat dhe fëmijët nga mosha 0-3 vjeç, dhe 6,302 përshkrime dhe intervenime mjekësore janë realizuar në ordinancat private dhe spitalet që bashkëpunojnë me QKMF-në. Njësia e vaksinimit ka realizuar 3,256 shërbime, ndërsa janë kryer gjithsej 601 kontrolla mjekësore stomatologjike.

Në laboratorin e QKMF-Doganaj janë kryer analiza laboratorike dhe biokimike për 159 pacientë, në laboratorin e QKMF për 6,803 pacientë, dhe në njësinë e rëntgenit janë shërbyer 2,356 pacientë. Shërbimet në fushën e pediatriisë kanë përfshirë 2,401 pacientë, në gjinekologji 1,069, në pulmologji 366 dhe në radiologji 229. Gjatë periudhës maj-qershor, janë realizuar gjithsej 3,743 shërbime të tjera- participim.

znj.Arta Avdiu: Jemi në muajin e ndërgjegjësimit, dhe dëshiroj t'ju përgëzoj për aktivitetet e shumta që keni realizuar, të cilat janë mbështetur si nga komuna, ashtu edhe nga QKMF-ja. E kam vërejtur që do të sillni aparaturën e mamografisë, dhe do doja të dija datën kur pritet të arrijë kjo aparaturë, që keni blerë për përdorim afatgjatë, jo vetëm ato që ishin në dispozicion për periudha të caktuara. Po ashtu, a keni staf të trajnuar për përdorimin e kësaj aparature?

z.Sinan Zeneli: Realistisht, është një lajm i mirë që po sjellim aparaturën për mamografi. Kjo marrëveshje është nënshkruar nga Kryetari dhe Islamic Relief, dhe vlera e saj është, nëse nuk gaboj, 108.000,00 €. Përdorimin e kësaj aparature shumica e stafit e njohin, por për këtë lloj aparature kërkohet një trajnim i veçantë. Besoj se trajnimet i kryem, pasi Ferizaj ka një qendër të specializuar për mamografin, me gjithë stafin atje, dhe jam i sigurt që ata kanë kryer trajnimet e nevojshme. Ky është një lajm shumë i mirë, pasi qytetarët tani mund të marrin shërbime edhe këtu, pranë nesh.

znj.Arta Avdiu: A ka ndonjë datë të caktuar kur do të sjellin këtë aparaturë?

z.Sinan Zeneli: Nuk kam informacione të plota, por ata kanë thënë se do të mundohet ta sjellin sa më shpejt që të jetë e mundur. Ka mundësi që aparatura të vijë para vitit të ri, por mund të ndodhi edhe në muajt në vijim. Megjithatë, Kryetari më ka thënë se ekziston mundësia që mamografia të vijë para vitit të ri.

znj.Arta Avdiu: Kur flasim për kancerin, e sidomos për kancerin e gjirit, i cili është një nga shkaktarët më të mëdhenj të vdekjeve tek gratë, nuk mund të lëmë pa përmendur edhe kancerin e qafës së mitrës, i cili gjithashtu ka një ndikim të rëndë. Këtu do të doja të bëja një kërkesë drejtuar Drejtorit të Shëndetësisë dhe juve, për të mundësuar realizimin e PAP testit, pasi komuna jonë nuk ka mundësi ta ofrojë këtë shërbim në vendin tonë. Kështu, qytetarët janë të detyruar të shkojnë jashtë qytetit, në Kaçanik, për të bërë PAP testin, kur dihet se ky është një nga analizat më të rëndësishme për të identifikuar herët kancerin e qafës së mitrës.

z.Sinan Zeneli: Kemi biseduar për këtë çështje, dhe zakonisht PAP testin mund ta bëjmë këtu. Problemi qëndron te leximi i rezultateve, pasi për këtë duhet të bëhet një kontratë me institutin për t'i lexuar ato rezultate. Strisha mund të merret lehtësisht, dhe mund të bëhen edhe pagesat nga komuna. Megjithatë, për leximin e rezultateve, është e nevojshme të kemi një kontratë me institutin patologjik

znj Arta Avdiu: A keni bërë diçka në këtë drejtim, apo jeni interesuar për këtë çështje?

z.Sinan Zeneli: Nuk kemi ndërmarrë ende veprime në këtë drejtim, por kemi shfaqur interes. Megjithatë, shumë nga këto shërbime janë paraparë tashmë në kuadër të statutit dhe janë pjesë e kujdesit primar shëndetësor. Nuk është një problem i madh për ta, dhe në të ardhmen mund të jetë e mundur t'i përfshijmë edhe këto shërbime. Kjo nuk është diçka që kërkon investime të mëdha

znj. Arta Avdiu: Pasi është shumë e nevojshme të bëhet një kontroll gjinekologjik, qytetarët tanë janë të detyruar të dalin jashtë qytetit për të realizuar PAP testin. Duke qenë se ky test është relativisht i kushtueshëm, pse nuk i jepni rëndësi të mundësohet që ai të ofrohet në komunën tonë?

z.Sinan Zeneli: Njëkohësisht, duhet të shqyrtojmë mundësitë që ofrohen nga udhëzimet administrative në fuqi. Nuk duhet të dalim jashtë kompetencave që na janë caktuar, por në këtë drejtim duhet të mendojmë për mundësitë që kemi dhe të shqyrtojmë pse jo, mundësinë e përmirësimit.

znj.Arta Avdiu: Meqenëse po flasim për analizat, desha të ndaj një përvojë personale. Pata rastin të bëj disa analiza dhe vura re se është shtuar numri i analizave që mund të bëhen në QKMF. Megjithatë, ajo që më bëri përshtypje ishte se analiza e urinës nuk ofrohet më. Pse është ndërprerë kjo analizë, kur dihet që ajo ka qenë në dispozicion për shumë vite në QKMF?

z.Sinan Zeneli: Kemi pasur mungesë stafit, por fatmirësisht kemi pranuar dy laborante deri tani. Këto janë procese që nuk i ndalim, por duhet të kemi parasysh se kur njëra prej stafit shkon në pushim lehonës, për shkak të mungesës së stafit dhe numrit të madh të pacientëve, jemi detyruar për një periudhë të caktuar të ndalim analizën e urinës,

z.Arben Thaçi: Sa herë në javë është pomologu QKMF ?

z.Sinan Zeneli: Pomologu për momentin është njëherë në javë dhe e financon fondi global për luftimin e tuberkulozit, faktikisht komuna në këtë drejtim nuk ka obligime.

Tash jemi tu bë përpjekje rishtas nëse bëhet kontratë për radiolog edhe këta tjera atëherë edhe pomologu me ekzistua mundësia që me kanë dy herë javë në Kaçanik.

znj.Arta Avdiu: Kam pasur rastin të shoh vazhdimisht konkursin për pozitë e gjinekologut dhe radiologut. A është gjinekologia ende e pranishme?

z.Sinan Zeneli: Po bëhen përpjekje për të lidhur kontratë të rregullt, sipas informacionit që kam. Edhe në konkursin e fundit, nuk ka pasur asnjë aplikant, që do të thotë se, sipas të gjitha gjasave, konkurset për gjinekolog, radiolog dhe biokimist kanë dështuar për shkak të mungesës së interesimit. Aktualisht, gjinekologia ka kontratë të veçantë të paraparë me prokurim, dhe kjo kontratë është në fuqi deri më 30 nëntor. Më 1 dhjetor, kontrata do t'i skadojë. Nëse nuk ka asnjë aplikant për konkursin e rregullt, atëherë do të jetë e nevojshme ta vazhdojmë kontratën edhe për një vit tjetër.

z.Ekrem Livoreka: Doja të pyesja për gjendjen e barnave esenciale, veçanërisht insulinës, si dhe sa shpesh vizitohen AMF-të nëpër fshatra dhe a janë ato funksionale?

z.Sinan Zeneli: Sa i përket insulinës, shumicën e kohës jemi të furnizuar nga Ministria e Shëndetësisë. Mund të them se 70% e buxhetit të përgjithshëm për barna esenciale është dedikuar për insulinën. Ka pasur momente të caktuara kur operatorët ekonomikë, pra Ministria, nuk ka mundur të kontrakttojë furnizuesit për disa procedura, ose kur procedurat kanë dështuar. Kështu, ka pasur periudha kur ka pasur mungesë insuline, jo vetëm në komunën tonë, por edhe në komuna të tjera. Megjithatë, furnizimi nuk është shumë i keq – në shumicën e rasteve është 100% i sigurt, ndërsa për barnat e tjera esenciale dhe materialet shpenzues, furnizimi është rreth 60-65% nga lista esenciale. Një zhvillim pozitiv është se komuna jonë ka kontraktuar një kompani për të siguruar furnizimin e barnave dhe materialeve shpenzues, të cilat financohen nga Ministria, dhe këto kompensohen nga komuna. Po ashtu, një tjetër arritje e rëndësishme është që komuna jonë ka krijuar një sistem kujdestarie për barnatoret, që shumica e komunave të Kosovës nuk e kanë. Kjo është një arritje e madhe, pasi në të kaluarën, kur ka pasur mungesë barnash apo ampulash, pacientët tanë kanë qenë të detyruar të shkojnë në Ferizaj për trajtim.

Sa i përket gjendjes në terren, aktualisht kemi 8 AMF (ambulanca mjekësore familjare) funksionale dhe 4 të tjera që nuk mund të konsiderohen si të funksionalizuara plotësisht. Nuk i quaj dezfunksionale, por janë të kufizuara për shkak të numrit të ulët të banorëve dhe mungesës së shërbimeve. Pavarësisht se shkojmë në fshatin Ivajë, ka ndodhur që brenda një muaji të kemi vetëm 5 pacientë. Për shembull, në Elezaj, banorët kanë deklaruar se nuk marrin shërbime, dhe kur e kemi vizituar këtë ambulantë, kemi parë se ka pasur shumë demolime. Gjendja ishte kaq e mjerueshme, Kështu, pas konsultave me administratorin e fshatit, ka ardhur kërkesa për ta ndryshuar destinacionin e kësaj ambulante, pasi nuk ofron shërbime dhe qytetarët kanë kërkuar që të zhvendoset në një vend tjetër. Pra, mund të themi që ajo ambulantë nuk është funksionale dhe ne nuk kemi dhënë shërbime aty. Me rregull kjo kërkesë duhet paraqitur në Kuvend për t'u miratuar si dhe me bërë një kërkesë në Ministrinë e Shëndetësisë për heqjen nga funksionimi. Sa i përket punës shëndetësore, situata është si më poshtë: në Doganaj aktualisht janë rreth 300 pacientë brenda muajit, në Glloboshicë janë 73 pacientë, ndërsa Bëgracë është në gjendje të mirë. Stagova ka rreth 20 pacientë, ndërsa Bobi vetëm 10 pacientë. Kjo do të thotë se po shkojmë ngadalë, por ne nuk do t'i mbyllim këto AMF, përkundrazi, mund të i bëjmë jofunksionale, pasi është një problem i madh që ka ndodhur. Duket se

infermierët mund të humbin aftësinë për intervenim dhe njëkohësisht, mjekët mund të humbin finesën e profesionit për shkak të numrit të ulët të rasteve. Nuk po them që ata do të harrojnë profesionin, por me më shumë raste, është më e thelbësishme të ruhet aftësia për të ofruar shërbime cilësore.

Për momentin, 8 nga AMF-të janë funksionale dhe 4 nuk ofrojnë shërbime. QKMF-ja ka katër mjekë familjarë që punojnë në turne, përfshirë specialistin e emergjencës, pediatriinë dhe radiologjinë, të cilët janë të pranishëm një herë në javë. Pulmologu është i financuar nga fondi global. Lajmi i fundit është se dy mjekë specialistë të mjekësisë familjare kanë përfunduar specializimin dhe tani jemi 4 mjekë të mjekësisë familjare. Një tjetër mjek është në fazën e specializimit dhe pritet që pas 2-3 viteve të përfundojë gjithashtu. Kjo na ndihmon të rrisim kapacitetin dhe të sigurojmë që shërbimet shëndetësore të ofrohen sipas udhëzimeve administrative për funksionimin e kujdesit primar shëndetësor.

z.Ekrem Livoreka: Drejtor, kur përmendët fshatin Elezaj, para se të filloni, ata kanë deklaruar që nuk duan të marrin shërbime, apo si ka ndodhur?

z.Sinan Zeneli: Jo, pasi është hapur dhe nuk e di për çfarë arsye, sepse ajo është rregulluar sipas standarteve. Atje janë paraparë të gjitha kriteret, përfshirë hapësirat për personat me aftësi të kufizuara, dhe janë instaluar tualetet. Por ka ndodhur që ato janë dëmtuar, u thyhen dhe u demoluan. E njëjta situatë ka ndodhur edhe në Strazhë, ku ka pasur akuza nëpër media për mungesën e mbulimit. Besoni, ata i kanë thyer, dhe unë nuk di se kur do të vetëdijesohen. Jam i shokuar dhe më vjen shumë keq që duhet të dal edhe nëpër media për të akuzuar qytetarët e mi.

znj. Arta Avdiu: Doja të lidhem me çështjen e stafit të infermiereve dhe të pyes a është numri i infermiereve i mjaftueshëm, veçanërisht gjatë vikendeve. Kam vënë re një rast kur duke dalë të gjithë, ka mbetur vetëm një infermiere në QKMF, dhe kjo infermiere ka kryer të gjitha shërbimet e nevojshme

z.Sinan Zeneli: Për të qenë të sinqertë, kërkesat janë shumë të mëdha. Ka raste kur ne shkojmë për vizita shtëpiake tek pacientët që kanë nevojë për kujdes paliativ, si ata me kancer në fazën e fundit apo pacientët që janë shtrirë në shtrat. Gjatë vizitave, ndodh që të dërgojmë ambulanca, dhe ka raste aksidentesh ku ne kemi dërguar nga 4-5 ambulanca. Po ashtu, kemi pasur raste kur kemi shkuar edhe në Ferizaj, siç e dini edhe ju, për rastin e djegies në Village, ku ka ndodhur një situatë emergjente. Besoni, as QKMF-ja e Ferizajt nuk ka intervenuar më shpejt se ne në Kaçanik. Kur kam telefonuar drejtoreshën e QKMF-së në Ferizaj dhe i kam thënë për ngjarjen që po ndodhte, ajo më tha se nuk kishte dijeni për situatën. I thashë nëse e dinte që kishte shpërthyer një zjarr përpara QKMF-së në Ferizaj. Nuk po e përmend spitalin, sepse nuk e di, por për QKMF-në, ne nga Kaçaniku kemi reaguar dhe kemi shkuar aty. Po ashtu, për raste të tjera, nuk hezitojmë të shkojmë kur është e nevojshme. Duket se ka shumë kërkesa dhe shërbime, dhe mund të ndodhë që të mbetemi vetëm me një infermiere në shërbim, por megjithatë, rëndësia e pacientëve është prioritet. Kjo do të thotë që mund të ketë disa vonesa në disa raste, por jemi shumë të angazhuar. Më pas, mund të punojmë edhe në ditët e shtunë për të plotësuar orët e punës, dhe ndoshta edhe të dielën, që do të thotë se punojmë jashtë orarit kur është e nevojshme.

znj.Arta Avdiu: Për të rritur stafin e infermiereve, fillimisht duhet të shqyrtojmë mundësitë e disponueshme, pra si është mundësia?

z.Sinan Zeneli: Stafi është rritur, dhe nëse jeni të informuar, ne kemi kërkuar vazhdimisht që të shtohet stafi. Aktualisht, ministria ka dërguar 15 vende të lira, prej të cilave 12 për QKMF-në. Kërkesa e ministrisë ka qenë që këto 12 vende të plotësohen me mjekë, por unë kam kërkuar dhe kam pranuar 9 infermierë, pasi kemi pasur mjaftueshëm mjekë. Deri tani, kemi pranuar edhe 3 mjekë. Po ashtu, që nga viti 2017, janë pranuar gjithsej 18 infermierë. Problemi aktual është se proceset fiziologjike si pushimet për lehonit dhe çështje të tjera po ndikojnë në disponueshmërinë e stafit, por nuk jemi në gjendje të keqe. E di që ndoshta do të duheshin më shumë infermierë, por për momentin këto janë mundësitë që kemi.

Po ashtu, desha t'ju informoj se jemi në fazën e tretë të projektit AQH, ku përfshihen 20 komuna, dhe tash është përfshirë edhe komuna e Kaçanikut. Ky projekt parashikon hapjen e një dhome për edukim shëndetësor për hipertensionin dhe diabetin, ku stafi është duke u trajnuar. Ata janë caktuar për të punuar dy ditë në javë dhe do të jenë të angazhuar për të ofruar shërbime, duke përfshirë mjekë dhe infermierë. Ky është një projekt i rëndësishëm për sensibilizimin e popullsisë.

znj.Arta Avdiu: Për psikolog, a keni shfrytëzuar mundësinë këtë shërbim, pasi këto gra kanë nevojë për këshilla dhe mbështetje psikologjike. Po ashtu, këtë muaj, në kuadër të muajit të ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit, me sjellë një psikolog në qendrën tonë për të ofruar ndihmën e duhur.

z.Sinan Zeneli: Unë, për të thënë të vërtetën, mendoj se psikologu duhet të jetë i pranishëm çdo ditë, jo vetëm gjatë këtij muaji. Edhe vitin e kaluar kemi bërë përpjekje për të sjellë një psikolog, por shumica nuk kishin licencë. Faktikisht, ne kemi kërkuar psikolog me licencë, por nuk ka pasur mundësi. Nëse ndonjë person ka marrë licencën, atëherë mund të planifikojmë, por unë jam për këtë mundësi gjatë gjithë vitit, jo vetëm për muajin e ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit. Kemi situata të ndryshme që kërkojnë mbështetje psikologjike, dhe tani po shohim gjithashtu edhe veprime devijante që janë shpesh rezultat i kohës bashkëkohore, e cila e bën të domosdoshme praninë e psikologut. Kështu që duhet të mendojmë për të ardhmen dhe se çfarë mund të bëjmë në këtë drejtim.

3. Të ndryshme:

Kryesues i Komitetit Ekrem Livoreka: A keni diçka për të diskutuar në pikën e ndryshme? Nëse jo, atëherë shpall mbledhjen të mbyllur në ora 14:25.

**Procesmbajtësja
Mavije Murseli**

**Kryesues i Komitetit për Komunitete
Ekrem Livoreka**